



SHLLJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"

STATUTI

I

SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE
JOPUBLIKE

"UNIVERSITETI MARIN BARLETI"

Tiranë, 2015

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Institucioni jopublik i arsimit të lartë SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, është i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 571 datë 25.09.2005, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ai e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Emri i tij i shkurtuar, për efekte të këtij statuti si dhe në marrëdhëniet me të tjerët, do të jetë **UMB**.

Neni 2

SHLUJ “Universiteti **Marin Barleti**”, në vijim **UMB**, është person juridik në formën e shoqërisë aksionare “Marin Barleti”, i njohur me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë Nr. **32511**, datë **06.12.2004**, dhe i regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me numër identifikimi **K52115006H**. Adresa e institucionit është: Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 41, Tiranë.

Neni 3

UMB përbëhet nga dy fakultete: *Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike* dhe *Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë*, të cilët përbëhen nga departamentet dhe njësi të tjera ndihmëse. Në përbërje të institucionit janë edhe Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit “Barleti” *IKZhB*, Instituti Shqiptar për Çështjet Publike *ISHÇP* dhe Instituti i Edukimit “Barleti” *IEB*.

Neni 4

UMB është institucion arsimor laik.

Neni 5

MISIONI I INSTITUCIONIT

UMB ka për mision të përgatisë studentë të një niveli të lartë, që të mund të realizojnë synimet e tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit e, mbi të gjitha, të zhvillojnë pasionet dhe interesat e tyre në funksion të komunitetit ku ata jetojnë dhe punojnë.

Neni 6

VIZIONI

Vizioni i **UMB** është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor, i cili ofron vlera të vërteta qytetarie dhe profesionalizmi; nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatisë qytetarë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv.

Neni 7

QËLLIMI

UMB ka për qëllim të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme, të bazuara në kërkim dhe njohuri shkencore, për të përgatitur specialistë dhe shkencëtarë të rinj.

UMB, në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, ka për qëllim të ofrojë gjithashtu programe studimi afatshkurtra për kualifikime e specializime, si dhe për përditësimin e dijeve të fituara.

Për përmbushjen e qëllimit të tij, **UMB** mund të bashkëpunojë e të lidhë marrëveshje me ente publike e private për veprimtari të përbashkëta didaktike, kërkimi, të konsulencës e shërbimeve në favor të të tretëve.

UMB angazhohet në promovimin, organizimin dhe realizimin e shërbimeve kulturore e formuese në territor rajonal e kombëtar.

Personeli akademik, drejtues, teknik-administrativ dhe studentët, si pjesë e **UMB**, kontribuojnë sipas fushës së tyre të kompetencave, funksioneve e përgjegjësisë në përmbushjen e qëllimeve institucionale të këtij institucioni të arsimit të lartë.

Neni 8

LIRIA AKADEMIKE DHE MOSDISKRIMINIMI

UMB respekton liritë akademike të personelit akademik në mësimdhënie e në kërkimin shkencor dhe të komunitetit të studentëve në nxënie, në kuptimin që shpreh ligji “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Veprimtaria e **UMB** me studentët, personelin akademik dhe personelin administrativ mbështetet në meritat personale dhe përjashton çfarëdo lloj diskriminimi në të gjitha format që mund të shfaqet.

Neni 9

NIVELI DHE PROGRAMET E STUDIMEVE

UMB ofron programe të studimeve universitare në tri cikle të njëpasnjëshme studimi në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë. Në përfundim të këtyre programeve, **UMB** lëshon diplomat përkatëse sipas cikleve të studimit dhe në fushat ku ai ofron programe studimi.

Njësitë kryesore të **UMB** mund të ofrojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë, ku shënohen njësitë bashkëpunuese të **UMB**.

UMB, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, mund të ofrojë programe të përbashkëta të studimeve, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë. Në të dyja rastet, në diplomat përkatëse shënohen institucionet bashkëpunuese.

Në vijim të studimeve të ndryshme universitare, **UMB** ofron edhe programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës: kualifikime e specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive, ofron forma të ndryshme të mësimin informal, sikurse, shkolla verore, konferenca dhe veprimtari të tjera të ngjashme. Në përfundim të këtyre programeve, **UMB** lëshon certifikatat përkatëse.

UMB mund të bashkëpunojë me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe të ofrojë programe studimi edhe të një modeli të ndryshëm nga ato të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe të bëra me dije publikut, kur diplomat lëshohen nga institucioni i huaj.

Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë shoqërohen me suplementin (shtojcën) e diplomës.

Për të gjitha programet e studimeve, veprimtaritë e ndryshme formuese vlerësohen në kredite ECTS të sistemit evropian, mbështetur në rekomandimet e legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 10

PROGRAMET E CIKLIT TË PARË

Programet e studimit të ciklit të parë i japin studentit njohuri bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme. Ato realizohen me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja e tyre normale është 3 vite mësimore ose 6 semestra.

Në përfundim të këtyre studimeve, studentit i lëshohet diplomë “Bachelor” në fushën e studimeve të kryera.

Neni 11 PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË

a) Master Shkencor.

Këto programe studimi i japin studentit njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti. Ato realizohen me 120 kredite ECTS ku përfshihen 30-40 ECTS për projektin kërkimor dhe tezën. Kohëzgjatja e tyre normale është 2 vite akademike ose 4 semestra. Studentët e këtyre programeve, para diplomimit, japin edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Në përfundim të këtyre programeve të studimit, studentit i lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e studimeve të kryera.

b) Master Profesional.

Këto programe studimi janë pjesë e studimeve të ciklit të dytë dhe i ofrojnë studentit arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Ato realizohen me 60-90 kredite ECTS dhe kohëzgjatja e tyre normale është 1-1.5 vite akademike.

Studentët e këtyre programeve, para diplomimit, japin edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Në përfundim të këtyre programeve të studimit, studentit i lëshohet diplomë “Master Profesional” në fushën e arsimimit dhe trajnimit të kryer.

Studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë dhe kanë fituar diplomën “Bachelor”, mund të ndjekin studimet në ciklin e dytë në programet Master Shkencor ose Master Profesional që ofron **UMB**, në një fushë të njëjtë, të afërt me të ose në fushën e formimit plotësues (minorit) të zgjedhur.

Studentet që kanë fituar një diplomë “Master Profesional”, mund të kryejnë plotësime të studimeve në programet Master Shkencor, sipas përcaktimeve që bëhen në rregulloret e programeve të studimit.

Neni 12 PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË

Studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë dhe kanë fituar diplomën “Master i Shkencave” mund të ndjekin studimet në ciklin e tretë, në programet e doktoratës ose në programe studimi specializimi apo kualifikimi për specialistë ekspertë, pas miratimit të këtyre programeve nga MAS.

Programet e doktoratës, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese zgjasin, të paktën, tre vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor”.

Programet e studimit të specializimit apo kualifikimit për specialistë ekspertë përmbajnë njohuri të thelluara profesionale teorike të kombinuara me aplikime praktike e trajnime. Në përfundim të këtyre programeve, lëshohet diplomë specializimi në fushën përkatëse.

UMB zhvillon programe të ciklit të tretë të universiteteve të huaja mbi bazën e marrëveshjeve konkrete, me miratim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS); ai, gjithashtu, organizon edhe të tilla studime me mundësitë e tij pas miratimit nga MAS, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë.

Neni 13 TË DREJTAT E INSTITUCIONIT

UMB ka të drejtë:

a) të miratojë struktura, plane dhe programe të veta mësimore;

- b)** të miratojë tekste, manuale dhe leksione për përdorim nga studentët e tij;
- c)** të përzgjedhë personelin akademik, personelin administrativ dhe atë ndihmës;
- ç)** të kërkojë nga të gjitha palët (personeli akademik, personeli administrativ dhe ai ndihmës, si dhe komuniteti i studentëve) respektimin e përgjegjësisë akademike;
- d)** të përcaktojë kritere për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve që regjistrohen për herë të parë dhe të atyre që transferohen;
- dh)** të anëtarësohet në shoqata e organizata universitare kombëtare dhe ndërkombëtare;
- e)** të krijojë lidhje bashkëpunimi me universitete dhe fakultete homologe brenda dhe jashtë vendit;
- f)** të krijojë misione dhe organizata jofitimprurëse në funksion të qëllimit të tij;
- g)** të bëjë të njohur dhe të promovojë përmes shtypit, medias ose me mjete të tjera ligjore qëllimin e tij, organizimin e tij, degët, diplomat, specialitetet dhe kualifikimet që ofron, si dhe arritjet dhe objektivat.

Neni 14 DETYRIMET E INSTITUCIONIT

UMB është i detyruar:

- a)** të zhvillojë procesin mësimor - kërkimor sipas standardeve të Hapsirës Europiane të Arsimit të Lartë;
- b)** të kryejë procesin e vlerësimit dhe të akreditimit për të gjitha programet e studimit dhe ta bëjë të njohur për publikun;
- c)** të bëjë publike kriteret për regjistrimin dhe ndjekjen e studimeve universitare në të gjitha ciklet e studimit në **UMB**;
- ç)** të bëjë publike kërkesat për cilësinë e personelin akademik dhe të kualifikimit, për profesoratin dhe anëtarët e organeve drejtuese;
- d)** të bëjë publike kërkesat për marrjen në punë të personelit administrativ dhe të personelit ndihmës.

KREU II STRUKTURA QEVERISËSE

Neni 15

Struktura qeverisëse e “Marin Barleti”-Sh.A. përbëhet nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm. Rregullat e funksionimit të tyre janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë me vendimin nr. 32511 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, më datë 6.12.2004.

Struktura qeverisëse e **UMB** përbëhet nga Bordi i institucionit si dhe nga organet dhe autoritetet drejtuese që janë: Rektori dhe Senati Akademik.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Neni 16

Asambleja e Aksionarëve e shoqërisë aksionare “Marin Barleti”-Sh.A.:

- a)** gëzon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, materialet didaktike dhe pronësinë intelektuale të krijuar dhe financuar nga **UMB**;
- b)** miraton politikat e zhvillimeve strategjike dhe kryerjen e investimeve të reja të propozuara nga Bordi i institucionit;
- c)** miraton buxhetin e propozuar nga Rektori dhe të shqyrtuar e të miratuar paraprakisht nga Bordi i institucionit.

Të drejtat dhe kompetencat e tjera Asambleja e Aksionarëve ia beson Bordit.

Neni 17

Asambleja e Aksionarëve përfaqësohet në Bordin e institucionit me 2 anëtarë pa të drejtë vote, për të bërë të njohur ose për të përcjellë qëndrimin ose mendimin e Asamblesë së Aksionarëve.

BORDI I SHLUJ “UNIVERSITETI MARIN BARLETT”

Neni 18

ROLI I BORDIT

Bordi i institucionit (më poshtë Bordi) orienton politikat e përgjithshme të organizimit, administrimit dhe zhvillimit të **UMB**, duke baraspeshuar politikën e ditës me planifikimin strategjik. Ai ndërmer politikë që i krijojnë mundësi institucionit të formulojë dhe kryejë misionin e vet në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me interesat e komunitetit dhe të vetë **UMB**.

Bordi ka rol këshillues për aksionarët dhe vendimmarrës për drejtuesit akademikë-administrativë të **UMB**.

Neni 19

ANËTARËT E BORDIT

Anëtarët e Bordit janë figura publike me përvojë, reputacion e kontribut në çështje administrative, ekonomike, social-kulturore dhe në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës.

Bordi përbëhet nga 7 - 9 anëtarë me të drejtë vote, si dhe 2 përfaqësues të Asamblesë së Aksionarëve dhe Rektori pa të drejtë vote. Anëtarët e Bordit kanë mandat dyvjeçar me të drejtë përsëritjeje.

Shtimi i anëtarëve të Bordit ose zëvendësimi i tyre bëhet me parapëlqimin në parim të Asamblesë së Aksionarëve dhe me shumicë votash nga anëtarët e Bordit.

Anëtarët e Bordit mund të largohen nga ky organ me vullnetin e tyre.

Neni 20

ORGANIZIMI I BORDIT

Bordi zgjedh midis anëtarëve me të drejtë vote Kryetarin e Bordit me një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari drejton veprimtarinë e Bordit dhe mbledhjet e tij. Në mungesë të tij, këtë detyrë e kryen një anëtar i Bordit, të cilit i delegohet detyra me gojë ose me shkrim nga vetë Kryetari.

Bordi cakton edhe një sekretar. Sekretari nuk është anëtar i Bordit, por pjesë e stafit të **UMB**. Bordi, gjatë veprimtarisë së tij, pas një këshillimi paraprak me Asamblesë dhe Aksionarëve dhe Rektori, mund të krijojë struktura ndihmëse e komisione për çështje të veçanta dhe për kohë të caktuar.

Me kërkesë të Bordit, Rektori i **UMB** mund të caktohet anëtar pa të drejtë vote në këto komisione.

Neni 21

MBLEDHJA E BORDIT

Mbledhja e Bordit quhet e vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve të tij. Mbledhja vjetore e Bordit mbahet në Shtator të çdo viti. Si rregull, Bordi thirret në mbledhje një herë në 3 muaj, me përjashtim të rasteve kur në mbledhjen e radhës vendoset ndryshe ose kur Kryetari i Bordit, Asambleja e Aksionarëve ose 1/3 e anëtarëve të Bordit kërkojnë mbledhje jashtë radhe. Në fillim të mbledhjes së Bordit bëhet miratimi i materialeve të mbledhjes së mëparshme, të zbardhura nga sekretari. Anëtarët e Bordit, përveç pjesëmarrjes me praninë e tyre fizike, mund të marrin pjesë në veprimtaritë e Bordit edhe me mënyra të tjera, të miratuara paraprakisht nga Bordi për çështje konkrete.

VEPRIMTARIA E BORDIT

Neni 22

Bordi përcakton misionin e institucionit dhe merr vendime e këshillon në përputhje me 'të.

Pas marrjes së pëlqimit nga Asambleja e Aksionarëve për disa kandidatura, Bordi përzgjedh me shumicë votash dhe emëron Rektorin e **UMB**, i cili është dhe autoriteti drejtues i institucionit. Për pezullimin apo lirimin nga detyra të Rektorit kërkohet miratimi me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të Bordit. Bazuar në deklaratën e qëllimeve, objektivave dhe arritjeve të paraqitura nga Rektori, Bordi shqyrton dhe bën vlerësimin vjetor të punës së Rektorit.

Me propozim të Rektorit, Bordi shqyrton dhe miraton me shumicë të thjeshtë votash një nga tre kandidaturat për Zëvendës Rektor, të përzgjedhura nga Rektori në konkurrimin e hapur. Për pezullimin apo lirimin e tij nga detyra kërkohet miratimi me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të Bordit.

Bordi së bashku me Rektorin shqyrtojnë punën dhe realizimet e detyrave nga Zëvendës Rektori dhe bëjnë vlerësimin vjetor të tij.

Neni 23

Bordi shqyrton dhe miraton me shumicë të thjeshtë votash:

- a) kriteret arsimore dhe të kualifikimit për rekrutimin e personelit akademik;
- b) përshkrimin e vendeve të punës dhe kriteret e konkurimit për stafin drejtues;
- c) procedurat e emërimeve, me qëllim shmangien e diskriminimit dhe konfliktin e interesave;
- ç) modelin e kontratave me kohëzgjatje të pakufizuar (pa afat).

Bordi është instanca më e lartë për të gjitha problemet që mund të lindin brenda institucionit për shkak të shmangies, përjashtimit ose mosrespektimit të kërkesave dhe procedurave të miratuara.

Neni 24

Për të realizuar funksionet e tij, Bordi:

- a) i rekomandon Asamblesë së Aksionarëve ndryshimet e nevojshme në infrastrukturë (mjedise mësimore dhe ndihmëse, teknologji të reja të mësimdhënies dhe edukimit, literaturë etj.), në cilësi akademike (kualifikime të trupit akademik, trajtime financiare, krijim i lidhjeve me institucione homologe etj) dhe në veprimtaritë e **UMB** (konferenca, takime, veprimtari publike, marketing etj.);
- b) jep rekomandime dhe orienton shfrytëzimin sa më të mirë të buxhetit të **UMB**, të dërguar në Bord nga Rektori, para miratimit përfundimtar të tij nga Asambleja e Aksionarëve;
- c) udhëzon dhe orienton për rritjen e efektivitetit të veprimtarive publike dhe të procesit të marketingut që zhvillohet në kuadër të vetë **UMB**;
- ç) miraton me 2/3 e votave të anëtarëve të tij statutin e institucionit dhe ndryshime të tij;
- d) nëpërmjet Rektorit, Rektoratit, dekanëve, komisioneve më të specializuara ose përfaqësuesve të nderit, ndihmon në krijimin e lidhjeve të **UMB** me institucione të tjera homologe, brenda dhe jashtë vendit;
- dh) nëpërmjet raportimeve të rregullta të Rektorit ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, mbikqyr veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të institucionit.

Neni 25

Me propozim të Rektoratit, Bordi:

- a) brenda buxhetit vjetor të miratuar, bën ndryshime dhe rregullime të domosdoshme të nivelit të pagesave të personelit akademik dhe të ftuar;

- b)** shqyrton dhe miraton politikat e përgjithshme operuese të **UMB**, politikat konkrete të mësimdhënies dhe rekrutimit të trupit akademik, programet jashtë-mësimore të kërkimit, botimet mësimore-shkencore, trajnimet e ndryshme, kriteret e dhënies së grandeve apo bursave të veçanta (brenda buxhetit të miratuar);
- c)** shqyrton dhe miraton dhënien e çmimeve të veçanta, të titujve a vlerësimeve të tjera të **UMB**.

Dokumentet përkatëse firmosen nga Kryetari i Bordit dhe Rektori.

Neni 26

Për mbarëvajtjen e punës, efektivitetin dhe operativitetin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore, Bordi, në mbledhje të veçanta të tij, autoritetin e këtyre çështjeve për ndjekje e zgjidhje ia delegon Rektoratit të **UMB**. Vendimet, udhëzimet, rregullat dhe kërkesat e Bordit i transmetohen personelit akademik dhe stafit administrativ nga Rektori.

ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE

Neni 27

a. Organi drejtues i **UMB** është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme.

Organi drejtues i Fakultetit është Këshilli i Fakultetit.

b. Autoriteti drejtues kryesor i **UMB** është Rektori; autoritete të tjera drejtuese janë: Zëvendës Rektori dhe Administratori i Deleguar.

Autoritetet drejtuese në Fakultet janë: Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, Përgjegjësi i Njësisë Kërkimore.

c. Organe kolegjiale të tjera janë Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës.

REKTORI

Neni 28

Rektori është autoriteti drejtues i **UMB**. Ai duhet të ketë titullin “Profesor” Ai përzgjidhet për një mandat trevjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje vetëm një herë të mandatit. Përzgjedhja e tij bëhet mes kandidatëve të paraqitur nga Asambleja e Aksionarëve, sipas përcaktimeve në këtë statut. Kontrata e tij e punës nënshkruhet nga Administratori i Deleguar.

Rektori kryeson Rektoratin dhe është Kryetar i Senatit Akademik. Në mungesë të Rektorit disa prej këtyre funksioneve i kryen Zëvendës Rektori, me urdhër dhe porosi.

Neni 29

Rektori përfaqëson **UMB** dhe vepron në emër të tij. Ai drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e Rektoratit, siguron menaxhim të frytshëm dhe kontroll të institucionit, mban përgjegjësi për zhvillimin e rregullt të procesit akademik dhe promovimin e punës së institucionit. Rektori garanton ekzekutimin e vendimeve të Bordit dhe i raporton atij për çështjet e drejtimit në të ardhmen, synimet strategjike, politikat dhe orientimin e zhvillimit të **UMB**, sipas planit të zhvillimit.

Kompetencat dhe detyrat kryesore të Rektorit janë:

a) Drejton dhe përfaqëson, zyrtarisht, **UMB**.

b) Drejton, organizon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor e kërkimor në institucion.

c) Kryeson Senatit e **UMB** dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me Bordin.

d) Në emër të Senatit i propozon Bordit qëllime, politika dhe veprime që u shërbejnë interesave më të mira të komunitetit dhe të **UMB**.

- e) Pas këshillimit me Senatin i rekomandon Bordit:
- kriteret arsimore dhe të kualifikimit për angazhimin e personelit akademik;
 - përshkrimin e vendeve të punës dhe kriteret e konkurimit për personelin drejtues;
 - procedurat e emërimeve, me qëllim shmangien e diskriminimit dhe konfliktin e interesave;
 - hartimin dhe lidhjen e kontratave me kohë të pakufizuar.
- f) Në emër të Senatit i propozon Bordit krijimin, shkrirjen ose ndryshimin e një hallke, të një shërbimi ose të një njësie mësimore-kërkimore ose administrative.
- g) Pas këshillimit me Senatin, i propozon Bordit dhënien e çmimeve titujve e vlerësimeve të tjera të **UMB**.
- h) Miraton ngarkesat mësimore të personelit akademik.
- i) Miraton strukturën akademike të vitit mësimor.
- j) Urdhëron fillimin e procesit për Vlerësimin e Brendshëm në institucion dhe bën kërkesën për akreditim institucional dhe për programet e studimeve.
- k) Miraton planet mësimore të programeve të studimit.
- l) Shfuqizon aktet e organeve drejtuese vartëse kur ato nuk respektojnë politikat e miratuara nga Bordi dhe bien ndesh me statutin, rregulloret e **UMB**, interesat e komunitetit dhe të institucionit.
- m) Miraton përgjegjësit e njëjësive kryesore dhe bazë, akademike apo kërkimore, pas procedurave të parashikuara në këtë statut.
- n) Miraton personelin akademik e kërkimor dhe atë ndihmës akademik, pas kryerjes së procedurave të përzgjedhjes sipas këtij statuti.

Përshkrim më i hollësishëm i detyrave të Rektorit bëhet në rregulloren e institucionit.

ZËVENDËS REKTORI

Neni 30

Për funksionimin më të mirë të tij **UMB** parashikon të ketë Zëvendës Rektor i cili ndjek zbatimin e politikave dhe vendimeve lidhur me procesin akademik, administrimin institucional, zbatimet dijeve të prodhuara në jetë e shoqëri, projektet kërkimore e zhvillimore që harton e zbaton institucioni.

Zëvendës Rektori zgjidhet për një mandat trevjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje të mandatit vetëm një herë. Ai duhet të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Përzgjedhja e tij, mes kandidatëve të paraqitur, bëhet sipas përcaktimeve në këtë statut. Ai lidh kontratën e punës me Administratorin e Deleguar. Pezullimi ose lirimi nga detyra i Zëvendës Rektorit para mbarimit të mandatit bëhet duke zbatuar procedurat e parashikuara në Nenin 22 të këtij statuti.

Neni 31

Zëvendës Rektori ndjek me përgjegjësi çështjet e ecurisë së procesit akademik si dhe ato të kërkimit, zbatimeve dhe projekteve. Ai i raporton drejtpërsëdrejti Rektorit. Zëvendës Rektori punon ngushtë me dekanët e fakulteteve dhe drejtuesit e instituteve të kërkimit dhe ka përgjegjësi të veçantë për të siguruar që synimet strategjike të institucionit të realizohen në veprimtarinë e përditëshme të tij; ai ndjek, gjithashtu, hartimin e projekteve kërkimore e zhvillimore, paraqitjen e tyre për financim dhe organizimin e zbatimit të projekteve të fituara.

Detyrat e Zëvendës Rektorit paraqiten në mënyrë të hollësishme në rregulloret e **UMB**.

ADMINISTRATORI I DELEGUAR

Neni 32

Administratori i Deleguar është përfaqësuesi i Asamblesë së Aksionarëve, i deleguar i Drejtorit të Përgjithshëm. Ai është autoriteti përgjegjës për drejtimin administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin/ekzekutimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarive financiare, për lidhjen e

kontratave të punës sipas përcaktimeve në këtë statut dhe zbatimin e tyre, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në institucion. Ai është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të strategjive të miratuara në **UMB**. Ai zgjidhet nga Asambleja e Aksionarëve për një periudhë 3 vjeçare me të drejtë ripërtëritje. Administratori i Deleguar lidh kontratën e punës me Asamblenë e Aksionarëve, ku palët bien dakord mbi kushtet e saj dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Administratori i Deleguar është pjestar i Rektoratit dhe, si i tillë, ndjek dhe mban përgjegjësi për çështjet që lidhen me menaxhimin financiar dhe politikat administrative të institucionit.

Në mungesë të Administratorit të Deleguar këto funksione i kryen Drejtori i Përgjithshëm.

REKTORATI

Neni 33

Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv i institucionit, i cili kryesohet nga Rektori dhe në përbërje të tij janë: Rektori, Zëvendës Rektori, Administratori i Deleguar dhe dekanët e fakulteteve. Në funksion të tematikës dhe trajtimit të problemeve, në mbledhjet e Rektoratit mund të ftohen të marrin pjesë drejtorë të instituteve etj. Rektorati është njësi administrative, që operon në mënyrë të pavarur sipas detyrave të përcaktuara në statut dhe në rregulloren e institucionit; ai ka edhe një sekretar.

Neni 34

Funksionet kryesore të Rektoratit janë:

- a) Harton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit;
- b) Harton programin vjetor të veprimtarive dhe ndjek zbatimin e tij;
- c) Formulon kritere për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
- ç) Harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim, organizon dhe mundëson projekte për programet e studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe ndryshime të nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- d) Zbaton të gjitha vendimet e marra nga Bordi;
- dh) Monitoron dhe publikon të gjitha rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të **UMB**;
- e) Përgatit marrëveshje bashkëpunimi mes institucioneve të arsimit të lartë vendase ose të huaja;
- ë) Propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjithë institucionin;

Detyra të tjera dhe funksionimi i Rektoratit përcaktohen në rregulloren akademike të institucionit.

SENATI AKADEMIK

Neni 35

Senati është organ kolegjal, vendimmarrës dhe këshillimor. Ai merr në shqyrtim problemet më të rëndësishme mësimore dhe shkencore, si dhe detyra të tjera të përcaktuara në këtë statut.

Anëtarë të Senatit Akademik janë:

- a) Për shkak të detyrës: Rektori, Administratori i Deleguar, Zëvendës Rektori, dekanët e fakulteteve, drejtuesit e instituteve kërkimore të **UMB**, drejtuesit e zyrave të sigurimit të standardeve të cilësisë.
- b) Të zgjedhur: dy anëtarë nga çdo fakultet si përfaqësues të personelit akademik, një anëtar përfaqësues nga personeli administrativ dhe dy përfaqësues nga Unioni Studentor.

Mandati i anëtarëve të Senatit, që janë anëtarë për shkak të detyrës, fillon dhe mbaron me emërimin dhe lirimin nga detyra. Mandati i anëtarëve të Senatit, që janë përfaqësues të personelit akademik me kontratë pa afat, është tre vjet me të drejtë ripërtëritjeje edhe një herë. Mandati i anëtarëve të Senatit, si përfaqësues

të personelit administrativ dhe atyre nga studentët, është një vit dhe me të drejtë ripërtëritjeje edhe një herë. Zëvendësimi brenda mandatit i një anëtari të Senatit bëhet me miratimin e shumicës së anëtarëve të tij. Anëtarët e zgjedhur në Senat zgjidhen me votim të anëtarëve të njësisë/strukturës që ata përfaqësojnë.

Anëtarët e Senatit, që përfaqësojnë personelin akademik, duhet si rregull të kenë titull akademik ose gradë shkencore “Doktor”.

Ata mund të jenë personel akademik ose personel akademik i ftuar. Rektori drejton mbledhjen e Senatit dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me Bordin.

Senati merr vendime me konsensus dhe kur kjo nuk arrihet, merr vendim me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet e tij Senati i bën të njohura nëpërmjet Rektorit. Si rregull, Senati mblidhet një herë në dy muaj me kërkesën e Rektorit. Rendi i ditës zakonisht propozohet nga Rektori. Senati mund të mblidhet gjithashtu në seanca të jashtëzakonshme me thirrjen e Rektorit ose kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve. Mbledhja e Senatit konsiderohet e rregullt kur në ‘të merr pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve.

Neni 36

Si organ vendimmarrës, Senati ka këto kompetenca:

- a) miraton planet mësimore dhe ato kërkimore të fakulteteve si dhe programet e reja të studimit;
- b) miraton kërkesën drejtuar Këshillit të Akreditimit për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit, akreditimin institucional etj.;
- c) përcakton normat vjetore të ngarkesës mësimore shkencore për personelin akademik;
- d) miraton rregulloret e institucionit dhe rregulloret e fakulteteve;
- e) vlerëson veprimtarinë mësimore kërkimore të personelit akademik të institucionit;
- f) vlerëson rregulloret mësimore të programeve të studimit;

Neni 37

Si organ këshillimor i Rektorit, Senati:

- a) propozon dhënien e çmimeve të veçanta, të titujve dhe nderimeve të tjera në **UMB**;
- b) propozon rregulla dhe kriteret për organizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve;
- c) propozon kriteret për sigurimin e cilësisë dhe standardeve në **UMB**;
- d) i propozon Rektorit kandidatura për dekanë të fakulteteve të përzgjedhur me konkurrim të hapur;
- e) ka edhe detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloret e institucionit.

Neni 38

Nëpërmjet Rektorit, Senati i propozon Bordit:

- a) objektiva, politika dhe veprime që u shërbejnë interesave të komunitetit dhe të **UMB**;
- b) krijimin, shkrirjen ose ndryshimin e një hallke, të një shërbimi ose njësie mësimore-kërkimore;
- c) politika konkrete të mësimdhënies dhe angazhimit të personelit akademik, programe të kërkimit, botime mësimore-shkencore, trajnime, kriteret dhënie të granteve e bursave të veçanta (në buxhetin e miratuar) etj.;
- ç) ndryshime ose amendamente në statutin e institucionit.

Neni 39

KËSHILLI I ETIKËS

Pranë **UMB** ngrihet Këshilli i Etikës i cili diskuton probleme të etikës së jetës akademike; ai i paraqet propozimet e nevojshme Rektorit lidhur me këto çështje.

Këshilli i Etikës përbëhet nga 7 anëtarë përfaqësues të personelit akademik, të cilët zgjidhen nga Senati.

Detyrat dhe funksionimi i Këshillit të Etikës përcaktohen në rregulloren e tij, e cila miratohet nga Senati.

KREU III ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I FAKULTETIT

FAKULTETI, AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE TË TIJ

Neni 40

Fakulteti është njësi kryesore e **UMB** që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti përbëhet nga departamentet dhe njësi të tjera bazë.

Organ drejtues i Fakultetit është Këshilli i Fakultetit. Autoriteti drejtues i Fakultetit është **Dekani**.

KËSHILLI I FAKULTETIT

Neni 41

Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës i fakultetit. Ai merr në shqyrtim dhe vendos për problemet më të rëndësishme të mësimdhënies, kërkimit dhe kualifikimit.

Këshilli i Fakultetit përbëhet nga 5 - 7 anëtarë, të cilët zgjidhen nga personeli akademik i fakultetit. Mandati i anëtarëve të Këshillit i Fakultetit është tre vjet. Zëvendësimi brenda mandatit i një anëtari të tij bëhet me kërkesë të departamentit përkatës.

Anëtarët e Këshillit të Fakultetit përfaqësojnë personelin akademik të fakultetit. Ata mund të jenë gjithashtu personel akademik i ftuar ose bashkëpunëtorë shkencorë të jashtëm. Si rregull, në Këshillin e Fakultetit përfaqësohen të gjitha departamentet dhe njësitë kërkimore të fakultetit. Përgjegjësi i Departamentit është edhe anëtar i Këshillit të Fakultetit; anëtarët e tjerë zgjidhet me votim të personelit të njësisë që përfaqësojnë.

Dekani është anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Fakultetit për shkak të detyrës dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me Senatin.

Dekani thërret Këshillin e Fakultetit në mbledhje të rregullta një herë në 2-3 muaj. Rendi i ditës zakonisht propozohet nga Dekani. Këshilli i Fakultetit mund të mbledhet edhe në seancë të jashtëzakonshme me thirrjen e Dekanit, ose kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve të tij.

Neni 42

Këshilli i Fakultetit ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) i propozon Senatit strategjinë e zhvillimit të fakultetit;
- b) i propozon Senatit ndryshime në normat vjetore të ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore;
- c) i propozon Senatit ndryshime dhe përmirësime në kurrikulat nëpërmjet futjes së lëndëve, grup lëndëve ose moduleve të reja, zëvendësimit ose përditësimit të moduleve ekzistuese, shtrirjes ose grupimit të lëndëve në vite, rivlerësimit të krediteve të lëndëve etj.;
- ç) merr në shqyrtim dhe propozon strukturën mësimore të vitit akademik;
- d) i propozon Senatit dhënien e çmimeve, titujve të nderit dhe vlerësime të **UMB** për persona të veçantë;
- e) miraton rregulloret e departamenteve;
- f) shqyrton e vlerëson planet mësimore të fakultetit dhe programet e reja të studimit dhe ia paraqet Rektorit për miratim;

g) rekomandon tekstet bazë për t'u përdorur nga ana e studentëve.

DEKANI

Neni 43

Dekani duhet të ketë, së paku, gradën shkencore “Doktor” dhe të jetë me përvojë akademike.

Dekani i Fakultetit lidh kontratën e punës me Administratorin e Deleguar pas miratimit nga Rektori. Marrëdhëniet ndërmjet institucionit dhe Dekanit të Fakultetit përcaktohen në kontratën e punës.

Neni 44

Dekani i Fakultetit mban përgjegjësi për organizimin e veprimtarive, për mbarëvajtjen dhe organizimin e procesit mësimor, të provimeve dhe diplomimeve. Ai ka këto detyra kryesore:

- a) organizon dhe drejton të gjithë punën mësimore dhe kërkimore të fakultetit;
- b) përfaqëson fakultetin dhe vepron në emër të tij në marrëdhënie me Senatin, Rektorin dhe Rektoratin;
- c) organizon dhe ndjek punën për të bërë të njohur arritjet e fakultetit nëpërmjet nxitjes së botimeve didaktike-shkencore, përfshirjes ose bashkëpunimit në projekte dhe nëpërmjet përditësimit të rubrikave përkatëse në faqen ueb të **UMB**;
- ç) është kryetar i Këshillit të Fakultetit;
- d) miraton strukturën mësimore të vitit akademik për fakultetin;
- dh) miraton orarin e mësimeve për fakultetin dhe atë të provimeve;
- e) i propozon Rektorit kandidaturat për përgjegjësit e departamenteve dhe të njëjstëve kërkimore.

Neni 45

Dekani është përgjegjës për hartimin e rregullores së brendshme të fakultetit dhe për organizimin e punës për hartimin e rregulloreve të departamenteve dhe të programeve të studimit. Dekani është përgjegjës për përgatitjen e projekt-buxhetit vjetor të fakultetit, për paraqitjen dhe mbrojtjen e tij përpara Rektoratit. Ai është njëkohësisht përgjegjës për realizimin e efektshëm të buxhetit vjetor të miratuar për fakultetin.

Dekani është i detyruar që në fund të vitit akademik t'i paraqesë për vlerësim Rektorit dhe nëpërmjet tij edhe Bordit raportin e arritjeve të fakultetit në përputhje me qëllimet dhe objektivat e tij.

Dekani është i detyruar që në fund të vitit akademik të bëjë vlerësimin e përgjegjësve të departamenteve në bazë të raporteve të tyre të arritjeve sipas qëllimeve dhe objektivave, përpara se ato t'i paraqiten për shqyrtim dhe vlerësim Senatit.

Detyra më të detajuara të Dekanit përcaktohen në rregulloret e institucionit.

Neni 46 ZËVENDËS DEKANI

Në varësi të natyrës së veprimtarisë, numrit të departamenteve dhe numrit të programeve që zhvillohen, Fakulteti mund të caktojë Zëvendës Dekan për anën mësimore. Kandidatura e tij i propozohet Rektorit nga Dekani i Fakultetit. Zëvendës Dekani lidh kontratën e punës me Administratorin e Deleguar pas miratimit nga Rektori. Marrëdhëniet ndërmjet tij dhe institucionit përcaktohen në kontratën e punës.

Detyrat e tij vendosen në rregulloren akademike të institucionit, kur lind nevoja e caktimit të tij.

Neni 47 DEKANATI

Dekanati është organ kolegjal i Fakultetit, i cili kryesohet nga Dekani dhe në përbërje të tij janë Dekani, Zëvendës Dekani (nëse ka të tillë) dhe përgjegjësit e departamenteve. Në funksion të tematikës dhe trajtimit të problemeve, në mbledhjet e dekanatit mund të ftohen të marrin pjesë drejtorë të instituteve, qendrave kërkimore, koordinatorët e grupeve mësimore, Dekani i Studentëve etj. Dekanati është njësi administrative, që operon sipas detyrave të përcaktuara në statut dhe në rregulloret institucionale.

Neni 48

Funksionet e Dekanatit janë:

- a) Harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë, mbështetur dhe në përputhje me ato institucionale;
- b) Koordinon veprimtarinë akademike, kërkimore dhe administrative të njësive bazë;
- c) Organizon dhe koordinon mësimdhënien në programet e studimit që mbulon Fakulteti;
- d) Inicion dhe nxit veprimtarinë inovative lidhur me zbatimet e kërkimeve shkencore të personelit të njësisë kryesore;
- e) Ndërmjetëson dhe lidh marrëveshje me institucione të ndryshme lidhur me praktikatat e studentëve në këto institucione.

KREU IV ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I DEPARTAMENTIT

DEPARTAMENTI

Neni 49

Departamenti është njësi bazë mësimore dhe kërkimore e fakultetit. Departamenti mbulon disa disiplina shkencore të ngjashme. Në departament përfshihet i gjithë personeli akademik dhe personeli ndihmës mësimor – shkencor përkatës.

Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit.

Neni 50

Departamenti ka këto detyra:

- a) shqyrton dhe harton planet mësimore dhe i propozon Këshillit të Fakultetit ndryshimet përkatëse;
- b) shqyrton dhe përpilon programet mësimore dhe bën ndryshimet e nevojshme;
- c) shqyrton dhe miraton tekstet bazë, tekstet plotësuese ose alternative dhe materiale të tjera didaktike për t'u përdorur nga ana e studentëve, dhe përgjigjet për vënien e tyre në kohë në dispozicion të studentëve;
- ç) shpall fushat e specializimit, ato të kërkimit dhe të kualifikimit që udhëheq departamenti;
- d) organizon punën kërkimore dhe atë botuese të personelit akademik të departamentit;
- dh) organizon mbështetjen dhe këshillimin e studentëve të vitit të fundit mbi mundësitë që ofron Departamenti për kualifikimin e mëtejshëm të tyre shkencor ose profesional;
- e) në përputhje me kërkesat dhe procedurat përkatëse, miraton kandidaturat për pedagogë me kohë të plotë dhe për punonjës kërkimorë.
- f) miraton rregulloret e programeve të studimit.

Detyra të tjera të departamentit detajohen në rregulloret e institucionit.

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT

Neni 51

Përgjegjësi i Departamentit organizon dhe drejton punën për njësinë bazë mësimore-kërkimore. Përgjegjësi i Departamentit duhet të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Ai bën pjesë në stafin drejtues akademik të fakultetit. Kandidatura e tij i propozohet Rektorit nga Dekani. Ai lidh kontratën e punës me Administratorin e Deleguar pas miratimit nga Rektori.

Neni 52

Përgjegjësi i Departamentit organizon dhe drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore për lëndët që mbulon departamenti, si dhe ndjek zbatimin e tyre.

Përgjegjësi i Departamentit i paraqet Dekanit kandidatët për personel akademik dhe personel akademik të ftuar. Administratori i Deleguar, pas miratimit nga Dekani, lidh kontratën e punës dhe atë të shërbimit me pedagogët, punonjësit kërkimorë dhe personelin e përcaktuar më sipër.

Përgjegjësi i Departamentit bën analizën e punës mësimore dhe kërkimore të departamentit dhe propozon ose merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj; ndjek dhe përgjigjet për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të departamentit.

Detyra të tjera detajohen në rregulloret e institucionit.

Neni 53

INSTITUTET DHE QENDRAT E KËRKIMIT DHE TË ZHVILLIMIT

Në **UMB** ngrihen dhe funksionojnë institutet dhe qendrat e kërkimit dhe zhvillimit, të cilat kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si dhe marrin pjesë në realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë.

Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit “Barleti” IKZHB, pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, është qendër për kërkimet ndërdisiplinore në fushat që lidhen me proceset e zhvillimit ekonomik, shkencor, teknologjik, social e kulturor të vendit, dhe të një forumi ku përfaqësues të botës akademike, biznesit, shoqërisë civile dhe politikës diskutojnë e zhvillojnë politika me interes publik.

Instituti Shqiptar për Çështjet Publike, ISHÇP, pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, është qendër edukimi dhe kërkimi për çështje që kanë të bëjnë me demokratizimin, qeverisjen e mirë dhe zhvillimin ekonomik e social në kuadër të proceseve të integritimit evropian të vendit. Ai shërben si mbështetës i reformave modernizuese dhe si një forum i debateve të aktorëve të ndryshëm në funksion të nxitjes dhe zhvillimit të tyre.

Instituti i Edukimit “Barleti”, IEB, pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, ka për qëllim qënien e një qendre studimore mbi zhvillimin dhe perspektivat e arsimit në përgjithësi, metodave bashkëkohore të mësimdhënies, formimit, trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të mësuesve, trajtimin e zhvillimin e çështjeve pedagogjike në arsim.

Institutet e kërkimit funksionojnë mbi bazën e rregulloreve përkatëse.

Pranë fakulteteve mund të ngrihen dhe të funksionojnë qendra kërkimi dhe zhvillimore. Fushat e kërkimit të qendrave harmonizohen me interesat e departamenteve të fakultetit.

KREU V

NJËSI TË TJERA MBËSHTETËSE ADMINISTRATIVE DHE TË SHËRBIMEVE

Neni 54

UMB zhvillon veprimtaritë e tij nëpërmjet njësive didaktike e kërkimore, si dhe të njësive të tjera mbështetëse administrative dhe të shërbimit.

Janë njësi mbështetëse administrative në **UMB**:

Sekretaritë mësimore të **UMB**;

Njësi të tjera administrative e funksionale, të përcaktuara dhe rregulluara nga Asambleja e Aksionarëve.

Janë njësi mbështetëse shërbimi në **UMB**:

– Bibliotekat;

– Salla kompjuterike të pajisura me internet;

– Struktura të tjera për të mbështetur e integruar veprimtaritë mësimore e kërkimore.

Neni 55

SEKRETARITË MËSIMORE

Në **UMB** funksionojnë sekretaritë mësimore, si: Sekretaria Mësimore Qendrore, sekretaritë mësimore të cikleve të studimit, apo të fakulteteve, si dhe njësi apo zyra të tjera që mund të krijohen jashtë fakulteteve, por që operojnë në shërbim të tyre dhe të institucionit.

Neni 56

KRYESEKRETARI

Sekretaria Mësimore Qendrore drejtohet nga Kryesekretari. Ai duhet të këtë përfunduar studimet universitare. Kandidaturat për Kryesekretarin, të përzgjedhura nga konkurrimi, i propozohen Rektorit nga komisioni i përzgjedhjes. Administratori i Deleguar lidh kontratën e punës pas miratimit nga Rektori.

Kryesekretari varet nga Rektori dhe ka përgjegjësi ligjore për regjistrimin dhe matrikullimin e studentëve, si dhe për krijimin, sistemimin dhe mbajtjen konform ligjit të të dhënave të tyre, për zbatimin e procedurave të transferimit të studentëve dhe përgjigjet për plotësimin e dokumentacionit përkatës.

Kryesekretari është përgjegjës për funksionimin e sekretarive mësimore dhe përgjigjet për funksionimin e tyre tek Rektori.

SEKRETARIA MËSIMORE QENDRORE

Neni 57

Sekretaria Mësimore Qendrore është strukturë administrative në shërbim të procesit mësimor në institucion. Ajo përgjigjet për gjithë organizimin dhe mirë funksionimin e procesit të provimeve, të regjistrimeve, të transferimeve, për procesin e lëshimit të diplomave, mbajtjen e regjistrit të të dhënave të studentëve etj. Sekretaria Mësimore përbehet nga Kryesekretari dhe sekretarët.

Detyrat e Sekretarisë Mësimore përcaktohen në rregulloret e institucionit. Sekretaria Mësimore organizon punën mbështetur në një rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Rektorati dhe miratohet nga Senati.

Neni 58

Sekretaritë mësimore të cikleve të studimit (apo, në rast nevojë, fakulteteve) koordinojnë punën mes Sekretarisë Mësimore Qendrore dhe fakulteteve. Ato ndihmojnë në kryerjen e detyrave administrative dhe në marrëdhëniet e Fakultetit me studentët. Detyrat e tyre dhe marrëdhëniet me Sekretarinë Qendrore përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizimit të punës së Sekretarisë.

Neni 59

NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Sigurimi i Cilësisë në **UMB** realizohet nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit të Sigurimit të Cilësisë.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga zyrat e sigurimit të standardeve të cilësisë. Organizimi dhe detyrat e zyrave të sigurimit të standardeve të cilësisë përcaktohen në rregulloren e institucionit.

Komisioni i Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore apo të zhvillimit, si dhe të veprimtarive administrative të institucionit. Përbërja e komisionit dhe detyrat përcaktohen në rregulloren e **UMB**.

Neni 60 NJËSIA E BOTIMEVE AKADEMIKE

Në **UMB**, për të realizuar botimet akademike në gjuhën shqipe të akademikëve vendas apo të huaj, funksionon njësia e botimeve akademike.

Vendimet për botimet merren nga bordi botues. Botimet e tilla mbajnë mbishkrimin “Barleti Press”.

KREU V PERSONELI I UMB

Neni 61

Personeli i **UMB** përbëhet nga:

- a) personeli akademik;
- b) personeli ndihmës mësimor-shkencor
- c) personeli administrativ.

Neni 62 PERSONELI AKADEMIK

Personeli akademik përbëhet nga profesorë, profesorë të asocijuar lektorë dhe asistentë-lektorë, të cilët kryejnë veprimtari të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Personeli akademik kryen edhe detyra administrative në ndihmë të institucionit, si edhe konsultim dhe këshillim për studentët.

Personeli akademik përzgjidhet me konkurrim nga një komision vlerësimi. Kriteret e konkurimit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Përbërja e komisioneve të vlerësimit përcaktohet nga Rektori. Miratimin e angazhimit të personelit e bën Rektori.

Neni 63 PERSONELI NDIHMËS MËSIMOR-KËRKIMOR

Personeli ndihmës mësimor-kërkimor përbëhet nga asistentë lektorët, personeli i instituteve dhe qendrave të kërkimit e të zhvillimit, laborantët, personeli ndihmës i departamenteve, të cilët mund të kryejnë veprimtari të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nën drejtimin e personelit akademik. Ata kryejnë njëkohësisht edhe veprimtari të tjera në ndihmë të institucionit, si edhe konsultim dhe këshillim për studentët.

Personeli ndihmës mësimor-kërkimor përzgjidhet me konkurrim nga një komision vlerësimi. Kriteret e konkurimit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Përbërja e komisioneve të vlerësimit përcaktohet nga Rektori. Miratimin e angazhimit të personelit e bën Rektori.

Neni 64

PERSONELI ADMINISTRATIV

Personeli administrativ përbëhet nga ai drejtues administrativ, punonjësit administrativë, të shërbimit dhe punonjësit e tjerë. Me konkurrim përzgjidhet vetëm personeli drejtues administrativ. Kërkesat e vendit të punës dhe kriteret e konkurrimit për personelin drejtues administrativ propozohen nga Administratori i Deleguar dhe miratohen nga Rektorati. Personeli administrativ mund të punësohet vetëm me kontrata me afate të caktuara, jo më shumë se një vit, me të drejtë ripërtëritjeje. Kontratat me të gjithë anëtarët e personelit administrativ nënshkruhen nga Administratori i Deleguar, i cili ndjek edhe zbatimin e kontratës dhe merr masa për zbatimin me përpikëri të tyre.

KREU VI PUNËSIMI DHE KUALIFIKIMI

Neni 65 KONFLIKTI I INTERESAVE

Punësimi në **UMB** mbështetet tërësisht në meritat individuale të personit dhe në përputhjen e tyre me kërkesat e vendit të punës. Personelit akademik nuk i lejohej të kryejë veprimtari tjetër fitimprurëse, jashtë ose brenda në mjediset e institucionit, kur kjo bie ndesh me veprimtarinë e tij në **UMB** dhe për pasojë krijon konflikt ose konkurrenca me interesat e **UMB**. Rastet e konfliktit të interesave dhe pasojat që ai mbart përcaktohen në kontratën e punës së nënshkruar. Anëtarët e personelit akademik të brendshëm, që janë të angazhuar në një veprimtari tjetër fitimprurëse, jashtë ose në mjediset e universitetit, duhet të vënë në dijeni me shkrim për këtë veprimtari eprorin e tyre të drejtpërdrejtë dhe Administratorin e Deleguar, pavarësisht nëse veprimtaria që kryejnë nuk bie ndesh me veprimtarinë e tyre në **UMB** dhe për pasojë nuk krijon konflikt ose nuk konkurrenca me interesat e **UMB**. Mosrespektimi i kësaj kërkesë ka për pasojë paralajmërimin deri në ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së punës.

KONTRATAT E PUNËS

Neni 66

Kontratat e punës me autoritetet drejtuese, personelin akademik, personelin ndihmës, personelin administrativ dhe atë ndihmës të **UMB** lidhen nga Administratori i Deleguar, i cili kryen këtë proces në emër dhe për llogari të Asamblesë së Aksionarëve. Kontratat e punës lidhen pasi është realizuar procesi i përzgjedhjes sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut për secilin rast.

Kontrata e punës me Administratorin e Deleguar lidhet nga Asambleja e Aksionarëve.

Kontratat e punës për gjithë personelin akademik lidhen dhe zgjidhen në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Kontratat e punës me personelin administrativ lidhen në përputhje me legjislativonin e punës dhe me këtë statut.

Administratori i Deleguar është përgjegjës për realizimin e kontratave të punës nga personeli i institucionit. Në kryerjen e këtij procesi ai bashkëpunon edhe me fakultetet dhe departamentet.

Neni 67

1. Kontratat e punës me personelin akademik lidhen me afat ose pa afat. Kur kontrata e punës është lidhur pa afat, ajo përfundon:

- a) kur punonjësi akademik jep dorëheqjen;
- b) kur punonjësi akademik del në pension;
- c) kur punonjësi akademik shkel kontratën e nënshkruar ose nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në të;
- ç) kur shkel rregullat e etikës së jetës akademike;

d) kur shkel rregullat e përcaktuara në këtë statut apo në rregulloren e institucionit.

2. Të gjitha kontratat e tjera lidhen me afat të caktuar.

Neni 68 KOHJA E PUNËS DHE E LEJES

Koha e punës për të gjithë personelin është 40 orë në javë.

Leja vjetore për personelin akademik, stafin drejtues administrativ dhe stafin ndihmës të departamenteve dhe fakulteteve caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për institucionet dhe qendrat kërkimore-shkencore dhe kushtet e kontratave individuale.

Për gjithë personelin tjetër, problemet që lidhen me kohën e punës dhe të lejes përcaktohen në përputhje me Kodin e Punës.

Neni 69 NORMA MËSIMORE-KËRKIMORE

Personeli akademik dhe personeli ndihmës mësimor-kërkimor janë të detyruar të plotësojnë normën mësimore dhe/ose shkencore sipas përcaktimeve në kontratën e punës. Norma mësimore shprehet në orë mësimore në auditor. Norma mësimore përcaktohet në varësi të statusit të punonjësit, detyrës dhe kualifikimit të tij.

Pjesën tjetër të kohës punonjësi është i detyruar t'ia kushtojë përgatitjes, kualifikimit, kërkimit shkencor, hulumtimit dhe publikimit të punës, dhe arritjeve të tij. Niveli i pagës së personelit akademik dhe personelit ndihmës mësimor-kërkimor lidhet drejtpërdrejtë me kualifikimin shkencor dhe rezultatet në punë.

Neni 70 KUALIFIKIMI

Personeli akademik gëzon të drejtën e avancimit të kualifikimit të tij shkencor dhe mund të punojë për përparimin e tij akademik. Gjatë kësaj periudhe personelit akademik, si rregull, nuk i ngarkohen detyra në mësimdhënie dhe **UMB** inkurajon përparimin e tij dhe krijon të gjitha lehtësitë e mundshme, sipas përcaktimeve në kontratën e punës. Anëtari i personelit akademik bën marrëveshje me eprorin për kushtet dhe modalitetet e kualifikimit të tij, si dhe për marrëdhëniet e punës. Në çdo rast kërkesa për kualifikimin e mëtejshëm duhet të miratohet paraprakisht edhe nga Dekani i Fakultetit përkatës, i cili analizon edhe kërkesat e institucionit për atë vend pune.

KREU VII FINANCIMI

Neni 71

UMB është institucion privat me vetëfinansim. Të ardhurat e tij krijohen nga tarifat e shkollimit të studentëve dhe nga burime të tjera të ligjshme.

UMB ka të drejtë të pranojë ndihma financiare, që lidhen me objektin e veprimtarisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

UMB paguan rregullisht taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve. Veprimtaria ekonomike e institucionit pasqyrohet në bilancet tremujore dhe vjetore të tij. Ai mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VIII STUDENTËT

Neni 72 PRANIMI I STUDENTËVE

Në **UMB** pranohen për t'u regjistruar në ciklet e ndryshme të studimeve shtetas shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë me dëftesë / diplomë ose dokument zyrtar të njësuar me to, mbarimin e një shkolle të mesme publike ose jopublike, e cila ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri ose jashtë vendit (në rastin e fundit, e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).

b) Në programet e studimit të ciklit të dytë Master Shkencor ose Master Profesional regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë me dokument zyrtar fitimin e një diplomë "Bachelor", në Shqipëri ose jashtë vendit (në rastin e fundit, e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit), në një fushë të njëjtë ose të afërt. Në rregulloret e çdo programi studimi të ciklit të dytë përcaktohen kritere specifike për pranimin e studentëve në 'të, që lidhen me drejtimin e formimit të tyre në ciklin e parë.

c) Në programet e studimit të ciklit të tretë regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë me dokument zyrtar fitimin e një diplome "Master i Shkencave" në Shqipëri ose jashtë vendit (në rastin e fundit, e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).

d) Në programet e studimit të të tre cikleve mund të regjistrohen edhe shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një shkollë universitare publike ose private, e cila ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri ose jashtë vendit (në rastin e fundit, të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit) dhe që ekuivalenohen nga njësitë përkatëse mësimore të **UMB**.

e) Për t'u regjistruar në një program studimi, duhet të pranohet pagimi i tarifës semestrale ose vjetore.

Çështje më të hollësishme që kanë të bëjnë me kushtet e pranimit në **UMB**, me procedurën e aplikimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, me regjistrimin e studentëve dhe me statusin e studentëve të regjistruar, përshkruhen në rregulloren e institucionit.

Neni 73 TRANSFERIMI I STUDENTËVE

UMB pranon transferime të studentëve në vitet e ndërmjetme nga shkollat e tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose private dhe lejon transferimin e studentëve të vet në shkolla të tjera të larta vendase ose të huaja, publike ose jopublike, sipas procedurave dhe modaliteteve të parashikuara në rregulloren e tij dhe në rregulloren e transferimeve.

Neni 74 KONTROLI DHE VLERËSIMI I DIJES

Çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e notave dhe të vlerësimit të dijes, format e kontrollit të dijes, si dhe organizimin dhe zhvillimin e provimeve dhe riprovimeve përshkruhen në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe në rregulloren e institucionit.

Neni 75 DIPLOMIMI I STUDENTËVE

Diplomimi i studentëve që përfundojnë studimet në **UMB** bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

KREU IX TE DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTIT

Neni 76

Studenti e fiton statusin si i tillë në **UMB** me regjistrimin e tij në institucion dhe e humbet atë me marrjen e diplomës ose me largimin nga **UMB**, sipas rasteve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloren e institucionit (transferime, ndërprerje e studimeve, përjashtim nga institucioni). Me fitimin e këtij statusi, studentit është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky statut dhe nga rregulloret e institucionit. Të drejtat dhe detyrimet e studentit përshkruhen më hollësisht në rregulloren e **UMB**.

Neni 77 UNIONI STUDENTOR

Për mirë organizimin e jetës studentore, studentët krijojnë Unionin Studentor, i cili funksionon në përputhje me statutin e miratuar nga Asambleja e Unionit Studentor.
Organet e Unionit zgjidhen me votim.

KREU X VULA ZYRTARE DHE STEMA

Neni 78

SHLUIJ **UMB** ka vulën zyrtare, ku shkruhet: “**UNIVERSITETI MARIN BARLETT**”.
Institucioni ka stemën e vet me mbishkrimin “**UMB**”.
Miratimi i tyre bëhet nga Asambleja e Aksionarëve dhe Bordi i **UMB**.

KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 79

Bashkëlidhur dhe mbështetur në këtë statut, **UMB** ka edhe rregulloren, e cila miratohet nga Senati. Fakultetet dhe njësitë e tjera të institucionit hartojnë rregulloret e veta, si dhe rregulloret mësimore të programeve të studimit.

Neni 80

Ky statut bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit dhe u shpërndahet të gjithë anëtarëve të personelit akademik dhe atij administrativ.

F U N D